




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02.Nr.18A/25
Më.31.01.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, 82 Statutit të Komunës së Mamushës.

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1

z.Erhan Taç zyrtar i teknologjisë informative në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, transferohet në Zyrtar i Lartë Për Teknologji Informative, në Kuadër të Kuvendit Komunal të Mamushës.

Neni 2

Vendimi i ri i punës është i kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.06 duke u bazuar në Ligji nr. 08/l-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2025 (Klasa GJ27 sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3

Nëpunësi fillon punën si Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative nga data 01.02.2025.

Neni 4

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në akt emërimin e nëpunësit civil.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

A R S Y E T I M

z. Erhan Taçi i punësuar në vendin e punës zyrtar i teknologjisë informative në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, për shkak të nevojës së institucioneve vartëse për zyrtar të Lartë të teknologjisë informative të Komunës si në Shkollë dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare me qëllim të zgjerimit të teknologjisë Informative dhe rregullimit të defekteve eventuale të pajisjeve teknologjike në Administratën Komunale dhe Institucionet Vartëse, vendoset që z. Erhan Taçi nga Zyrtar për Teknologji Informative në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme të Transferohet në Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative në Kuadër të Kuvendit Komunal të Komunës së Mamushës, me qëllim të përmisimit dhe funksionalizimit të gjithë pajisjeve teknologjike në kuadër të gjitha Institucioneve vartëse të Komunës së Mamushës.

Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil, Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil.

Prandaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, Kryetari i Komunës konstaton se nevoja për transferimin e përhershëm është e arsyeshme.

Prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- z. Ethan Taçi;
- Zyra e Kryetari të Komunës;
- Personeli
- arkivi.

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Zyra e Kryetarit

Nr.

Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 39 paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të Republikës së Kosovës dhe në bazë Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores numër 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës, me datë: 31.01.2025, merre këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës, për zhvillimin e Procedurave për pranimin në shërbimin civil, për pozitën Zyrtar për Informim, e planifikuar me Planin e Personelit për vitin 2025.
- II. Zyra e Personelit është e obliguar që ti zbatoj të gjitha dispozitat ligjore të cekura me lartë në lidhje me autorizimin e cekur.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

ARSYETIM

Zyrtari për Informim në Komunën e Mamushës ka dhënë dorëheqje nga puna me vetëdëshirë, dhe se është pozitë e cila i duhet një Institucioni Publik.

Andaj, obligohet zyra e personelit që në afat sa më të shkurtër të bëjë zhvillimin e procedurave për hapjen e konkursit në pozitën Zyrtar për Informim.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e personelit,
2. Arkivi komunal.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Zyra e Kryetarit

02 Nr. 17/25

Me 29.01.2025

Mamusha

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme Administrative, si dhe duke u bazuar në Statutin e Komunës së Mamushës 2008, kërkesës së Menaxherit të Kontratës, Kryetari I Komunës merr këtë:

AKTVENDIM

I

APROVOHET- Kërkesa e Menaxherit të Kontratës me numër të protokollit 02-13-25 të datës 29.01.2025, për aprovimin e kërkesës për barazim të pozicioneve- kolaudim në projektin me titull “Rikonstruktimi i rrugës “Bahcelik” në Mamushë”-Ritender me numër të idnetifikimit Nr. prokurimit 626-24-10882-5-2-1.

II

Ky aktvendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

ARSYETIM

Me datën 29.01.2025 është paraqitur një kërkesë me numër të protokollit 02-13-25 nga menaxheri i kontratës për aprovim të pozicioneve -kolaudimit në projektin me titull “Rikonstruktimi i rrugës “Bahcelik” në Mamushë”-Ritender me numër të idnetifikimit Nr. prokurimit 626-24-10882-5-2-1.

Kryetari i Komunës bazuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentacionin e bashkangjitur, kërkesën ku është e përshkruar detalisht ecuria e punëve dhe rrjedha e projektit e aprovon kërkesën e menaxherit të kontratës për barazim të pozicioneve- Kolaudim. Pasi që janë identifikuar disa mospërputhje ndërmjet paramasës fillesatare dhe gjendjes faktike në teren të cilat janë të domosdoshme për përfundimin e suksesshëm të projektit dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara për cilësinë dhe funksionalizimin e infrastrukturës.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Zyra e Kryetarit aprovon kërkesën e Menaxherit të Kontratës për barazimin e pozicioneve.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalase - Izlaza - Outgoing	16-25
025	No. Nr.
Tarih/Gj	29.01.2025

02 Nr. 16 /25
Me datë 29.012025

Në bazë nenit 13 dhe 58 paragrafi 1 pika (b) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 20 të Ligjit Nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik dhe neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës morri këtë:

VENDIM

Për emërimin e autoritetit përgjegjës

I

Themelohen autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit në kuadër të Komunës së Mamushës.

II

Përbërja dhe struktura e autoritetit përgjegjës është si në vijim:

1. Z.Çabej Nurkollar – Zyra Ligjore e Komunës së Mamushës – Kryesues
2. Znj.Sihana Uka Opsional- Udhëheqëse e Personelit.
3. Znj. Seylan Mazrek – Zyrtare në Administratë – Opsional – Përgjithshme anëtare e njësisë së autoritetit përgjegjës

III

- Për të përmbushur detyrat e tij në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, autoriteti përgjegjës është i autorizuar që të:
- Mbledh dhe pranon nga burime të ligjshme informata për interesat privatë të një zyrtari, përfshirë të dhënat publike ose private, informata të ofruara nga media dhe ankesat e qytetarëve sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe dispozitat të tjera ligjore në fuqi.
- Kërkoj nga zyrtari i përfshirë në hetimin e rastit të konfliktit të interesit të paraqesë informacione shtesë ose deklaratën të interesit privat të zyrtarit sipas kërkesës.
- Regjistrojë interesin privat të zyrtarit.
- Verifikojë besueshmërinë e burimeve dhe informatave për të vërtetuar konfliktin e interesit.
- Verifikojë rastet e konfliktit të interesit dhe të vendosë nëse ka shkelje të dispozitave ligjore në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit ose dispozitave të tjera ligjore.
- Të propozojë veprime dhe aktivitete të mëtejshme në parandalimin e konfliktit të interesit në institucion, të informojë Agjencinë përkatëse.

- Të informojë zyrtarët e rinj dhe të zhvillojë trajnime të rregullta të zyrtarëve dhe t'i këshillojë ata për parandalimin e konfliktit të interesit.
- Kryejë aktivitete të tjera në këtë drejtim nëse është e nevojshme.
- Si dhe në tërësi të respektohet Ligji Nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konflikt Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

VI

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 02.Nr.70-24 e datës 13.05.2024


V

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit

VI

Këshilla Juridike- Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mamushës, dhe atë në afat prej 30 ditësh.

Me këtë vendim njoftohen:
Te Emëruarit
Drejtoritë Komunale.
Zyra e Personelit.






02 Nr. 15/25
Me 28.01.2025
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa e Antaresisë për Asociacionin e Komunave të Kosovës

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës për pagesën vjetore të Antaresisë sipas faturës Nr.19/25 datë 28.01.2024.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Nr.	Blloku Kodues	ID Furnitorit	Xhirollogaria	Shuma €
1.	10/626/16314/13480/00000/0133	51018001	1901586841031197	826.05

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Buxhet, Financa/ZKF
- Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Arkivi






02 Nr. 14 /25
Më:24.01.2025
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 dhe sipas Vendimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës datë 23.09.2020, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa e Antarësisë viti 2025 për AZHR-Jug

Neni 1

Aprovohet kërkesa e AZHR-Jug për pagesën vjetore të antarësisë për vitin 2025 sipas kërkesës 02 Nr.08-24 datë 24.01.2025.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Nr.	Blloku Kodues	ID Furnitorit	Xhirollogaria	Shuma €
1.	10/626/48014/13480/00000/0411	51121783	1705001600068752	2,000.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria për Buxhet, Financa/ZKF
- AZHR-Jug
- Arkivi





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlaza - Outgoing		
02	No.Nr.	13-25
h/Di.		22.01.2025

02 Nr. 13/25
Me 22.01.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG 02/nr.68/24 e datës 02.10.2024 dhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërkomunal në zonën ekonomike jug të datës 10.12.2016 dhe termave të referencës për themelimin dhe funksionimin e ekipit rajonal (ERPK) nr.27022020 ERPK, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

1. Komuna e Mamushës- dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.
2. Bazuar në Memorandumin me nr të protokollit 02-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financon projektin në fjalë për implemnetimin e këtijë projekti nga AZHR-Jug, e cila udhëheqë dhe mbikqyr projektin në fjalë.
3. Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit. 10/626/48014/13460/00000/0411 për periudhën janar 2025 në shumën prej 5,346.80€.
4. Për zbatimin e këtijë vendimi ka obligim Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

- Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik
- Palëve
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 12/25
Me 22.01.2025
Mamushë

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamusa-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalışa - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 12-25
Tarih/Dt.	22.01.2025

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG 02/nr.68/24 e datës 02.10.2024 dhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërkomunal në zonën ekonomike jug të datës 10.12.2016 dhe termave të referencës për themelimin dhe funksionimin e ekipit rajonal (ERPK) nr.27022020 ERPK, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

1. Komuna e Mamushës- dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.
2. Bazuar në Memorandumin me nr të protokolit 02-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.
3. Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit. 10/626/48014/13460/00000/0411 për periudhën janar 2025 në shumën prej 8,393.20€.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ka obligim Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

- Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik
- Palëve
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullah Krasniq



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. ____/25
Me 21.01.2025
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa vjetore e anëtarësimit për Qendrën e Strehimit të Grave dhe Fëmijëve-Prizren

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Drejtoris për Buxhet dhe Financa, për pagesën ndaj Qendrës për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren, konform Memorandumit të Mirëkuptimit në mes komunave të Regjionit dhe kësaj Qendre nënshkruar me datë 24.11.2022 konform pikës 1 të nenit 3 duke respektuar nenin 4 të këtijë memorandumit.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të bllokut kodues:
Përshkrimi: Pagesa e anëtarësimit për Qendrën e strehimit të grave dhe fëmijëve-Prizren
10/626/16014/13480/00000/0111

Furnitori	Xhirollogaria	Shuma €
51109554	1404000003714159	1.000.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtora për Buxhet dhe Financa-ZKF
- Qendra për strehimin e Grave dhe Fëmijëve-Prizren
- Arkiva





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02 No.Nr.	10-25
Tarih/Dt.	20.01.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 10 -25

Me 20.01.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenin 75 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës dhe lidhur me vendimin 02.Nr.09/5 të datës 20.01.2025 kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1

Në bazë të vendimit 02.Nr.09/25 të datës 20.01.2025 ***Për ndërprjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje*** z. Idriz Mazrek largohet nga lista e pagave.

Neni 2

OBLIGOHET- Zyra e personelit që të njëjtën ta nxjerrë nga lista e pagave, nga data 01.03.2025

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Idriz Mazrek zyrtar për informim pranë Komunës së Mamushës me datë 20.01.2025 iu është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas vendimit 02.Nr.09/25 të datës 20.01.2025 ***Për ndërprjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje***. Andaj duke u bazuar Ligjin nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik bëhet largimi nga lista e pagave në kuadër të Zyrës së Kryetarit.

Njoftohen

1. Z. Idriz Mazrek
2. NJMBNJ.
3. Thesari
4. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës
Abdullah Krasniqi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02- Nr 09-25

Me datë 20.01.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenin 75 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, Rregullore (QRK) nr.29/2024 Për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, deklarata për dorëheqje nga marrëdhënia e punës me nr. protokollit 02.Nr-05-25 të datës 20.01.2025, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës kryetari i Komunës, merr

A K T V E N D I M

Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit civil

I

z. Idriz Mazrek me numër personal [REDACTED] të lëshuar nga MPB i sistemuar në vendin e punës sipas akt emërimit- Zyrtar për informim pranë Komunës së Mamushës, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 28.02.2025, dorëheqje me vetë dëshire.

II

Obligohet zyra e Personelit që nga data 01.03.2025 ta largon nga lista e pagave.

III

Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

z. Idriz Mazrek me numër personal [REDACTED] nga Komuna e Mamushës, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në vendin e punës dhe detyrat e punës sipas akt emërimit- Zyrtar për informim pranë Komunës së Mamushës.

z. Idriz Mazrek nëpunës civil përmes letër dorëheqjes iu është drejtuar Kryetarit të Komunës së Mamushës, me të cilën ka bërë deklaratën e dorëheqjes me datë 20.01.2025 me numër të protokollit 02.Nr.05-25 e datës 20.01.2025, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje nga Shërbimi Civil.

Marrëdhënia e punës i ndërpritet duke filluar nga data 01.03.2025, sipas dispozitave ligjore në fuqi i ndërpritet marrëdhënia e punës me vetë dëshirë të shërbyesit civil.


Andaj, pas administrimit të provave dhe të fakteve mbi gjendjen reale, dhe arsyetimeve të shënuara në letër dorëheqjen e z. Idriz mazrek zyrtar për informim pranë Komunës së Mamushës, është pranuar dorëheqja nga shërbimi civil, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

Të njoftohen :
z. Idriz Mazrek
Zyra e Personelit
Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamusha Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamusha-Municipality of Mamusha	
Çikës - Dalëse - Izlazi - Outgoing	
02 No.Nr.	08-25
Tarih/Dt. 20.01.2025	

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUŠA

Zyra e Kryetarit

02 Nr. 08/25

Me 20.01.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës) NR.21/18 shtator 2023, lidhur me nenin 12, paragrafi 1 dhe 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën E Pranimit të nëpunësve në Shërbimin Publik nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

V E N D I M

Komisioni i pranimit për pozitat të kategorisë profesionale për Mjekë të Përgjithshëm

Neni I

Komisioni i Pranimit përbëhet nga:

1. Znj. Sihana Uka- Kryesuese Menaxhere e personelit
2. Z. Ramadan Mazreku – anëtarë Shef i QKMF-së
3. Z. Mirat Morina - anëtarë- Udhëheqës i Sektorit në QKMF
4. Znj.Xhenana Hyseni-anëtare-Mjeke e Përgjithshme
5. Z.Beqir Kokollari – anëtarë- i Mjek i Përgjithshëm

Neni II

Komisioni i pranimit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

Neni III

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për ProcedurëPranimit të nëpunësve në Shërbimin Publik.

Kryetar i Komunës së Mamushës

Abdullah KRASNIC





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Datëse - Izlaza - Outgoing	No.Nr. 07-25
Tarih/Dt.	10.01.2025

ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 07-25

Me datë: 10.01.2025

Komuna e Mamushës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 13 i Ligji nr. 08/1-196 Për Pagat në Sektorin Publik neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës në Mamushës bie këtë:

VENDIM

Ndryshim në Listën e Pagave

Neni 1

1. Shefkije Morina – Zyrtare për Buxhet dhe Financa 2 sipas aktemrimit, në Drejtorinë Komunale të Arsimit transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-92070-0980.

Neni 2

Obligohet- Zyra e personelit që ta zbatoj këtë vendim.

Me këtë vendim njoftohet

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Sistemi i Pagave — Thesar (MFPT)
- Arkiva





02 Nr. 06/25
Me 10.01.2025
Mamushë

Republika e Kosovës -- Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova -- Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi -- Komuna e Mamushës
Opština Mamuša -- Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Qasja në SIMFK për vitin 2025

Neni 1


Nr.	Emri dhe Mbledhja	Klasa funksionale në SIMFK	Qasja e përdoruesit	
			I rregullit	Alternativ
1	XHEVAHIRE GASHI	Pamje Raportim ZKF - OB	E rregullit	
2	XHEVAHIRE GASHI	Moduli i Planit të Parasë së Gatshme	E rregullit	

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :


- Të emëruarit
- Departamenti i Thesarit-MFPT
- Arkiva





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 05 /25

Me 10.01.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligji nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës me datën 10.01.2025 bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Retroaktive

Neni 1

znj. Nurgul Morina nga Komuna e Mamushës me numër personal: [REDACTED], në bazë të Kontratës së punës me numër të protokollit 02-209-24 të datës 10.12.2024 me titull të pozitës Mësimdhënëse Mbështetëse, në "SH.F.M.U ANADOLU".

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Arsimit që për të lartcekurën të përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të pagesës retroaktive në bazë të Vendimit për hyrje në listë të pagave me numër të protokollit 02-239-24 të datës 10.12.2024, me titull të pozitës, Mësimdhënëse mbështetëse, për pagesën e diferencës së pagesës në shumën prej 117.63€ Bruto.

Neni 3

Paga do të bëhet duke u bazuar në Ligjin nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Klasa E21 Koeficienti 5.1. sipas nënprogramit 10-626-93391-0912.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi me datën 10.01.2025.

ARSYETIM


Znj. Nurgul Morina me datën 10.12.2024 ka nënshkruar kontratën e punës në pozitën Mësimdhënëse Mbështetëse, në "SH.F.M.U ANADOLU", dhe me datën 10.12.2024 është dërguar vendimi për hyrje në listë të pagave me numër të protokollit 02.Nr.239-24, në Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT).

Me të pranuar listën e pagave kemi vërejtur se Znj. Nurgul Morina, është paguar në shumën prej 280.5 € Bruto, ndërsa nga themelimi i marrëdhënies së punës nga data 10.12.2024 deri me datën 31.12.2024 janë gjithsej 22 ditë dhe si rrjedhojë është dashur të paguhet në shumën bruto prej 398.13 €. Andaj, duhet të paguhet diferenca prej 117.63 € në Bruto.

Me këtë vendim njoftohet :

- DAKRS
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 04-25

Me datë: 01.01.2025

Komuna e Mamushës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 13 i Ligji nr. 08/1-196 Për Pagat në Sektorin Publik neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës në Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Ndryshim në Listën e Pagave

Neni 1

1. Hilmi Sala – Zyrtar për Marëdhinë me Publikun, i emëruar sipas Vendimit 02.Nr.173-21 e datës 31.12.2021, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
2. Mehmet Mazrek Asistent Administrativ në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal sipas i emëruar sipas vendimit 01.Nr-033-21 e datës 31.12.2021, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
3. Muvedet Bujari Asistente Administrative në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës e caktuar sipas vendimit 02.Nr-039-20 e datës 30.04.2020, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
4. Sihana Uka Udhëheqëse e personelit në Komunën e Mamushës sipas Akt emërimit Nr.025 e datës 03.05.2024 transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
5. Vedat Morina shef i kabenitetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës i caktuar sipas vendimit 02.Nr-172-21 e datës 31.12.2021 transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.

Neni 2

Obligohet- Zyra e personelit që ta zbatoj këtë vendim.Me këtë vendim njoftohet :

A R S Y E T I M

Të lartë përmendurit janë në bllokut kodues nën-programe të tjera, pasi që në kohën e futjes në listë të pagave nuk ka pasur vende të lira në nën-programi 10-626-16014-0111, (Zyra e Kryetarit të Komunës), pas miratimit të buxhetit 2025, në nën-programi 10-626-16014-0111, janë liruar vendet dhe të lartpërmendurit të transferohen në kategorinë e lartcekur.

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e Personelit
- Sistemi i Pagave — Thesar (MFPT)
- Arkiva


Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 04-25

Me datë: 01.12.2021

Komuna e Mamushës

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 13 i Ligji nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës në Mamushës bie këtë:

VENDIM

Ndryshim në Listën e Pagave

Neni 1

1. Hilmi Sala – Zyrtar për Marëdhinë me Publikun, i emëruar sipas Vendimit 02.Nr.173-21 e datës 31.12.2021, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
2. Mehmet Mazrek Asistent Administrativ në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal sipas i emëruar sipas vendimit 01.Nr-033-21 e datës 31.12.2021, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
3. Muvedet Bujari Asistente Administrative në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës e caktuar sipas vendimit 02.Nr-039-20 e datës 30.04.2020, transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
4. Sihana Uka Udhëheqëse e personelit në Komunën e Mamushës sipas Akt emërimit Nr.025 e datës 03.05.2024 transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.
5. Vedat Morina shef i kabenitetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës i caktuar sipas vendimit 02.Nr-172-21 e datës 31.12.2021 transferohet në listën e pagave sipas bllokut kodues nën-programi 10-626-16014-0111.

Neni 2

Obligohet- Zyra e personelit që ta zbatoj këtë vendim.Me këtë vendim njoftohet :

ARSYETIM

Të lartë përmendurit janë në bllokut kodues nën-programe të tjera, pasi që në kohën e futjes në listë të pagave nuk ka pasur vende të lira në nën-programi 10-626-16014-0111, (Zyra e Kryetarit të Komunës), pas miratimit të buxhetit 2025, në nën-programi 10-626-16014-0111, janë liruar vendet dhe të lartpërmendurit të transferohen në kategorinë e lartcekur.

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e Personelit
- Sistemi i Pagave — Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuša



08 Nr. 05 -25

Me 09.01.2025

Në bazë të nenit 21 të Ligji nr. 08/1-197 Për Zyrtarët Publik, Nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 12 pika 1 dhe 2.1 të Rregullore (QRK) nr. 04/2024 Për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijushmërinë e Zyrtarëve Publik dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 01/2018 Për Rregullimin e Procedurave Administrative të Kompensimit Për Pushimin e Lehonisë të Paguar nga Qeveria, Drejtori i DSHMS bie këtë

V E N D I M

- I. **Znj. Sevgi Mazrek** me numër personal [REDACTED] në pozitën **Infermiere pranë QKMF në Mamushë**, i lejohej pushimi lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh duke filluar prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025.
- II. Pagesën për 6 muajt e parë duke filluar nga data 01.01.2025 deri më 30.06.2025 do ta bëjë punëdhënësi në lartësi prej 70% të pagës bazë nga mjetet buxhetore ku lehona është duke punuar.
- III. Pagesën për 3 mujorin në vijim do të paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë duke filluar nga data 01/07/2025 deri më 30.09.2025 në lartësi prej 50% të pagës mesatare.
- IV. E punësuar ka të drejtë me ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjera **pa pagesë**

A r s y e t i m

Znj. Sevgi Mazrek, e punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës me datën 24.12.2024, ka bërë lindjen e saj me të cilin e ka vërtetuar me fletëlëshim nga Qendra Klinike Universitare Klinika Obsterike Gjinokologjike në Prishtinë,

Pas shqyrtimit të kërkesës vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- Punëtores;
- Zyra e Pagesave dhe
- arkivi.

Kryetari i Komunës i Komunës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02.Nr. 02 /2025

Me_09.01.2025 Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës ,të dates 01.12.2008 Kryetarui I Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë e Kujdestarisë QKMF - Mamushë

Neni . 1

Aprovohet kërkesa e Qendrës së Mjeksisë Familjare-Mamushë për pagesën e kujdestarisë, per muajin **Dhjetor/2024**,

Neni . 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë te dedikuara për periudhen **01.12.2024 deri 31.12.2024**, ne shumën prej **2.526,95€** nga programi **Sherbimet e Shëndetesisë Primare**, kodi **73850** nga kategoria paga dhe mëditje.

Neni . 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.


Me këtëvendim të njoftohet :

1. Drejtoria e Shëndetesisë dhe Mirqenje Sociale
2. Departamenti i pagave-Thesar
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniqi





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŠA BELEDIYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

Zyra e Kryetarit
02 Nr. 01 /25
Me 08.01.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 6 dhe 7 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për ndarjen e Subvencioneve me Nr. 1.Nr.-007-19 e datës 28.03.2019, lidhur me nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.5 dhe nenit 36 i Rregullit Financiar nr.01/2013 MF Shpenzimi i parave publike dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të personave fizik dhe juridik nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere.

Neni 1

Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të personave fizik dhe juridik nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kulturës, rinisë dhe sportit, bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 2

Komisioni i caktuar si në nenin 1 të këtij vendimi, do të ketë këtë përbërje.

1. Çabej Nurkollar- Kryesues
2. Suna Morina – Anëtare
3. Sibel Taç- Anëtare
4. Gulan Kruezi Anëtar
5. Seylan Alaybeg- Anëtare
6. Emrah Morina (Anëtar rezervë)

Neni 3

Komisioni i caktuar në nenin 1 të këtij vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do ti ushtron bazuar në Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për ndarjen e Subvencioneve me Nr. 1.Nr.-007-19 e datës 28.03.2019, dhe do ti rekomandon Kryetarit të Komunës Listën e përfituesve të subvencioneve për marrjen e vendimit përfundimtar.

Neni 4

Ky komision ka mandat një vjeçar dhe të funksionoj deri me datën 31.12.2025, për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të personave fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Mamushës.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Njoftohen:

- Të gjitha Drejtoritë
- Anëtarët e Komisionit
- Arkiva

Kryetar i Komunes së Vranushës
Abdullah KRASNIQ





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUŠA

Zyra e Kryetarit
02 Nr. 01/25
Me 08.01.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 6 dhe 7 paragrafi 1 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për ndarjen e Subvencioneve me Nr. 1.Nr.-007-19 e datës 28.03.2019, lidhur me nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.5 dhe nenit 36 i Rregullit Financiar nr.01/2013 MF Shpenzimi i parave publike dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të personave fizik dhe juridik nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere.

Neni 1

Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të personave fizik dhe juridik nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kulturës, rinisë dhe sportit, bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 2

Komisioni i caktuar si në nenin 1 të këtij vendimi, do të ketë këtë përbërje.

1. Çabej Nurkollar- Kryesues
2. Suna Morina – Anëtare
3. Sibel Taç- Anëtare
4. Gulan Kruezi Anëtar
5. Seylan Alaybeg- Anëtare
6. Emrah Morina (Anëtar rezervë)

Neni 3

Komisioni i caktuar në nenin 1 të këtij vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do të ushtron bazuar në Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për ndarjen e Subvencioneve me Nr. 1.Nr.-007-19 e datës 28.03.2019, dhe do të rekomandon Kryetarit të Komunës Listën e përfituesve të subvencioneve për marrjen e vendimit përfundimtar.

Neni 4

Ky komision ka mandat një vjeçar dhe të funksionoj deri me datën 31.12.2025, për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të personave fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Mamushës.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Njoftohen:

- Të gjitha Drejtoritë
- Anëtarët e Komisionit
- Arkiva

Kryetar i Komitetit të Mamushës

